ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2017-2025

Shkolla e Mesme Profesionale “Hamdi Bushati”

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2017-2025) 10
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025) 17
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2017-2025) 18
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2017-2025) 18
Tabela 5: Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2017-2025) 25
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2017-2025) 26
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2017-2025) 27
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2017-2025) 27
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025) 30
Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2017-2025) 32
Tabela 11: Metodat e kërkimit për punë (2020-2025) 33
Tabela 12: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025) 33
Tabela 13: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2017-2025) 34
Tabela 14: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2024) 35
Tabela 15: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2017-2025) 37

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 10
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 11
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025) 11
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 12
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2017-2025) 13
Figura 6: Punësimi kundrejt vetë-punësimit (2017-2025) 13
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 14
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025) 15
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2017-2025) 15
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2017-2025) 16
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025) 17
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 19
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2017-2025) 20
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 20
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025) 21
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2017-2025) 22
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2017-2025) 23
Figura 18: Lloji i kontratës (2017-2025) 23
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2017-2025) 24
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025) 26

Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025) 28
Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025) 28
Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2025) 29
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025) 30
Figura 25: Papunësia ndër vite (2017-2025) 31
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025) 31
Figura 27: Të diplomuarit papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2017-2025) 34
Figura 28: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2025) 35
Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2025 36

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3
Lista e figurave 3
Gjetjet kryesore 6
Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 8
Të diplomuarit 2017-2025 10
Analiza e rezultateve 12
Statusi i punësimit 12
Lidhja e punës me fushën e arsimit 15
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 18
Niveli i pagave 19
Kushtet e punës 22
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 25
Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 25
Mënyrat e gjetjes së punës së parë 27
Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 28
Të diplomuarit pa punë 31
Propozimet për përmirësim në shkollë 34
Planet për të ardhmen 37

Gjetjet kryesore

Ky raport paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i nëntë brezave të të diplomuarve të shkollës "Hamdi Bushati" duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2017.

- Në vitin 2025, 74% e të diplomuarve në vitin 2024 ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit. Viti 2025 shënon një rritje të rritje të punësimit me 19 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2017-2024 (55%).
- Ndërkohë, 18% e të diplomuarve janë të papunë me një ulje prej 9 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (27%). Student/kursant janë vetëm 6% (N=8) e të gjurmuarve, me një ulje prej 4 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (10%).
- Për vitin 2025, të diplomuarit e drejtimit Hoteleri-Turizëm kanë normën më të lartë të punësimit me, të diplomuarit e drejtimit Tekstil-Konfeksione kanë normën më të lartë të papunësisë por dhe normën më të lartë të ndjekjes së studimeve të mëtejshm. Përkatësisht, 77% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 50% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione dhe 74% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes janë të punësuar një vit pas diplomimit. Të papunë janë 33% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione, 23% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 14% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm. Ndërkohë studentë janë 6% e të diplomuarve në Hoteleri – Turizëm dhe 17% e të diplomuarve në Tekstil Konfeksion.
- 74% e të diplomuarve në vitin 2025 u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit me një rritje prej 19 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (55%). Përkatësisht, 82% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 55% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes pohojnë lidhje mes punës dhe fushës së tyre të arsimit dhe 67% prej të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione nuk punon në profesion.
- 57% e të gjurmuarve pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë "shumë" dhe "jashtëzakonisht shumë", duke shënuar një rritje me 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (51%).
- Për vitin 2025, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 38% deri në 50,000 lekë, 18% në fashën 50,001 – 60, 000 lekë, 13% në fashën 60, 001 – 80, 000 lekë, 15% në fashën 80, 001 – 95, 000 lekë, 6% në fashën 95,001 lekë – 120,000 lekë dhe 11% paguhen më shumë se 120,001 lekë.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve, një pagë deri në 50,000 lekë e marrin 33% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione, 22% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 43% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm. Ndërkohë, një pagë 50,001 – 60, 000 lekë e marrin 39% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 12% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm. Pagë në fashën 60,001 lekë – 80,000 lekë marrin 17% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 12% e të diplomuarve në Hoteleri- Turizëm. Një pagë në fashën 80,001 – 95,000 lekë e marrin 11% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 16% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 33% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksion. Ndërkohë 6% nga të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm dhe 33% nga të diplomuarit në Tekstil- Konfeksion marrin pagë në fashën 95,001-

120,000 Lekë. Një pagë mbi 120,000 lekë marrin 11% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes dhe 12% nga tl diplomuarit në Hoteleri- Turizëm.


- 86% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit, me një rritje prej 26 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (60%).
- Për të nëntë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. Mesatarisht 70% e të diplomuarve gjatë viteve 2017-2024 kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale.
-]Për të diplomuarit e vitit 2054 kjo përqindje është 50%, duke shënuar një ulje me 20 pikë përqindje për këtë kategori. Ndërkohë, 74% e të diplomuarve në vitin 2025, ndjehen "të sigurt" ose "shumë të sigurt" në vendin e punës, me një rritje prej 18 pikë përqindje nga mesatarja 2017-2024 (56%). Ndërkohë, 7% e të diplomuarve të gjurmuar janë shprehur se ndjehen "shumë të pasigurt", me një rënie me 3 pikë përqindje nga mesatarja 2017-2024 (10%).
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2024, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim "shumë/jashtëzakonisht shumë". Përkatësisht, theksi vendoset tek përmirësimi i teksteve dhe materialeve (33%), përmirësimi i bashkëpunimit me bizneset (32%), praktika në biznes (32%), aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (32%), metodat e mësimdhënies (32%)
- Brenda dy viteve të ardhshme, 57% e të diplomuarve kanë dëshirë të fillojnë biznesin e tyre, me një rritje prej 22 pikë përqindje nga mesatarja 2017-2024 (25%). Për më tepër, 17% kanë dëshirë të jenë të punësuar. Ndërkohë, 13% kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimeve, me një ulje prej 12 pikësh përqindje në raport me mesataren 2017-2024 (25%).

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla **"Hamdi Bushati"**, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për Punë’.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **nëntë brezave me të diplomuar** të shkollës “Hamdi Bushati”.

Të diplomuarit 2017-2025


Në vitin shkollor 2024-2025 në shkollën "Hamdi Bushati" u diplomuan 131 nxënës (shiko tabelën 1), 9 nxënës më shumë se në vitin 2023-2024.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2017-2025)

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2016-2017	102	91	89%
2017-2018	87	60	69%
2018-2019	70	56	80%
2019-2020	95	88	93%
2020-2021	93	93	100%
2021-2022	144	144	100%
2022-2023	151	148	98%
2023-2024	122	118	97%
2024-2025	**131**	**131**	**100%**

Nga të diplomuarit e vitit 2024-2025 u gjurmuan 131 nxënës ose 100% e të diplomuarve. Nga këta, 30% (N=39) ishin vajza dhe 70% (N=92) ishin djem (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** (N=131)

Shpërndarja e të gjurmuarve sipas drejtimeve jepet në figurën 2. Përkatësisht, 64% e të gjurmuarve i përkasin drejtimit Hoteleri-Turizën, 27% Ekonomi-Biznes dhe 9% Tekstil Konfeksion.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** (N=131)

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 93% e të diplomuarve janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri dhe 7% jetojnë jashtë vendit (shiko figurën 3). Mesatarisht, gjatë viteve 2020-2025, 85% e të diplomuarve të gjurmuar jetojnë në Shqipëri dhe 15% jashtë vendit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=88); **2021** (N=93); **2022** (N=144); **2023** (N=148), **2024** (N=118), **2025** (N=131)

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2024-2025), nga një total prej 131 të anketuarish 52% (N=68) ishin të punësuar, 19% (N=25) ishin të vetëpunësuar, 3% (N=4) ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë, ishin 6% (N=8) ishin (student/kursant . Ndërkohë, të papunë ishin 18% (N=24) të diplomuar një vit pas diplomimit.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** (N=131)

Referuar figurës 5, 74% e të diplomuarve në vitin 2025 ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit. Viti 2025 shënon një rritje të rritje të punësimit me 14 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2017-2024 (60%). Ndërkohë, 18% e të diplomuarve janë të papunë me një ulje prej 9 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (27%). Student/kursant janë vetëm 6% e të gjurmuarve, me një ulje prej 4 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (10%).


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017** (N=91); **2018** (N=60); **2019** (N=56); **2020** (N=88); **2021** (N=93); **2022** (N=144); **2023** (N=148), **2024** (N=118), **2025** (N=131)

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2025, 52% e të diplomuarve të cilët janë në marrëdhënie pune janë të punësuar dhe 19% janë të vetë-punësuar (shiko figurën 6). Mesatarisht, gjatë viteve 2017-2025, 48% e të diplomuarve që janë në marrëdhënie pune janë të punësuar dhe 10% të vetë-punësuar.


Figura 6: Punësimi kundrejt vetë-punësimit (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017** (N=91); **2018** (N=60); **2019** (N=56); **2020** (N=88); **2021** (N=93); **2022** (N=144); **2023** (N=148), **2024** (N=118), 2025 (N=131)

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re të diplomuarit e drejtimit Hoteleri-Turizëm kanë normën më të lartë të punësimit, të diplomuarit e drejtimit Tekstil-Konfeksione kanë normën më të lartë të papunësisë. Përkatësisht, 77% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 50% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione dhe 74% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes janë të punësuar një vit pas diplomimit. Të papunë janë 33% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione, 23% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 14% e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm. Ndërkohë studentë janë 17% e të diplomuarve në Tekstil Konfeksion dhe 6% e të diplomuarve në Hoteleri- Turizëm dhe 3% të diplomuarve në Ekonomi-Biznes.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** N_{EB}=35; N_{HT}=84; N_{TK}=12;

Të disagreguara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se përkatësisht 80% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 59% e të diplomuarve të gjinisë femërore janë të punësuar një vit pas diplomimit. Të papunë janë 13% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 31% e të diplomuarve të gjinisë femërore. Studime të mëtejshme ndjekin 4% e djemve dhe 10% e vajzave.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025)




***Shënim**: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** N_M=92; N_F=39*

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 74% e të diplomuarve u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit, ndërsa 26% u shprehën që nuk lidhet. Nga viti 2017 deri në 2024 (shiko figurën 9), mesatarisht 55% e të diplomuarve pohuan se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit dhe 45% se puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit. Si rezultat, për vitin 2025 vërehet një përmirësim me 19 pikë përqindje e të diplomuarve që pohojnë se puna lidhet me fushën e arsimit në krahasim me mesataren e viteve 2017-2024.


Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017** (N=44); **2018** (N=24); **2019** (N=26); **2020** (N=51); **2021** (N=68); **2022** (N=104); **2023** (N=87), **2024** (N=68), **2025** (N=85)

Nëse analizojmë lidhjen e punës sipas drejtimit (shiko figurën 10), vërehet se të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm për të shtatë brezat e gjurmuar pohojnë një lidhje më të madhe të punës me fushën e arsimit. Mesatarisht, gjatë viteve 2017-2025, 70% e të diplomuarve në drejtimin Hoteleri-Turizëm, 30% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 36% e të diplomuarve në Tekstil Konfeksione pohojnë lidhjen mes punës dhe fushës së arsimit.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2017**: N_{EB}=15; N_{HT}=21; N_{TK}=8; **Baza 2018**: N_{EB}=4; N_{HT}=13; N_{TK}=7; **Baza 2019**: N_{EB}=7; N_{HT}=15; N_{TK}=4; **Baza 2020**: N_{EB}=15; N_{HT}=32; N_{TK}=4; **Baza 2021**: N_{EB}=13; N_{HT}=50; N_{TK}=5; **Baza 2022:** N_{EB}=12; N_{HT}=80; N_{TK}=;12 **Baza 2023:** N_{EB}=12; N_{HT}=74; N_{TK}=1, **Baza 2024:** N_{EB}=17; N_{HT}=55; N_{TK}=5, **Baza 2025:** N_{EB}=22; N_{HT}=57; N_{TK}=6

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 71% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 75% e të diplomuarve të gjinisë femërore janë të punësuar në një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** N_M=56; N_F=16

Të gjurmuarit të cilët kanë pohuar se puna e tyre nuk përputhet me fushën e tyre të arsimit janë pyetur më tej për arsyet e mospërputhjes (shiko tabelën 2). Sikurse vihet re, të diplomuarit gjatë vitit 2024-2025 japin tre arsye kryesore: (i) kushtet më të mira të punës aktuale (33% në 2025, mesatarja 2018-2024, 44%), (ii) pamundësia për të gjetur një punë e cila lidhet me studimet (33% në 2025, mesatarja 2018-2024, 12%) dhe (iii) mungesa e dëshirës për të punuar në një punë e cila lidhet me profesionin (33% në 2025, mesatarja 2018-2024, 30%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	100%	64%	85%	42%	19%	23%	32%	**33%**
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	9%	0%	4%	0%	20%	9%	**33%**
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	0%	0%	5%	0%	11%	7%	5%	**0%**
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	0%	27%	10%	38%	62%	40%	50%	**33%**
Tjetër	0%	0%	0%	15%	8%	10%	5%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=11); **2019** (N=11); **2020** (N=20); **2021** (N=26); **2022** (N=37); **2023** (N=30), **2024** (N=22), **2025** (N=20).

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimeve i përdorin në vendin e tyre të punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në vitin 2025 tregojnë se njohuritë përdoren "shumë dhe jashtëzakonisht shumë" nga 57% e tyre. Mesatarisht, 51% e të diplomuarve në vitet 2017-2024 kanë pohuar se i përdorin "shumë/jashtëzakonisht shumë" njohuritë e fituara në shkollë. Si rezultat, për vitin 2025 vërehet një rritje me 6 pikë përqindje e të diplomuarve që pohojnë se i përdorin "shumë/jashtëzakonisht shumë" njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë në vendin e punës.

Ndërkohë, 7% e të diplomuarve janë përgjigjur se i përdorin "aspak" njohuritë e fituara gjatë

studimeve, me ndryshime me 8 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 e cila është 15%. Ndërkohë për vitin 2025 është rritur me 7 pikë përqindje numri i të diplomuarve të cilët pohojnë se i përdorin "disi" njohuritë e fituara gjatë studimeve në vendin e punës (20% në 2025, mesatarja 2017-2024, 13%).

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2017-2025)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2017	26%	15%	17%	26%	17%
2018	0%	29%	17%	38%	17%
2019	11%	39%	4%	21%	25%
2020	4%	31%	4%	55%	6%
2021	25%	13%	18%	16%	28%
2022	19%	19%	17%	13%	31%
2023	14%	8%	15%	14%	50%
2024	9%	20%	17%	20%	35%
2025	**7%**	**17%**	**20%**	**23%**	**34%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=54); **2018** (N=24); **2019** (N=28); **2020** (N=51); **2021** (N=68); **2022** (N=104); **2023** (N=102), **2024** (N=77), **2025** (N=85)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 54% e të diplomuarve në vitin 2025 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me "shumë dhe jashtëzakonisht shumë". Nga ana tjetër, 25% e vlerësojnë me "aspak dhe pak" lidhjen mes punës dhe studimeve. Mesatarisht gjatë viteve 2017-2023, 46% e të diplomuarve e kanë vlerësuar me "shumë dhe jashtëzakonisht shumë" lidhjen mes punës dhe studimeve , ndërkohë që 41% e vlerësojnë me "aspak dhe pak".

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2017-2025)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë


2017	30%	9%	22%	30%	9%
2018	46%	4%	17%	21%	13%
2019	25%	29%	11%	11%	25%
2020	12%	37%	6%	39%	6%
2021	35%	6%	7%	19%	32%
2022	25%	18%	13%	13%	31%
2023	20%	8%	12%	13%	48%
2024	13%	10%	17%	29%	31%
2025	**6%**	**19%**	**22%**	**19%**	**35%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=54); **2018** (N=24); **2019** (N=28); **2020** (N=51); **2021** (N=68); **2022** (N=104); **2023** (N=103), **2024** (N=77), **2025** (N=85)

Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2025 (shiko figurën 12), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 37% deri në 50,000 lekë, 18% 50,001 – 60,000 lekë, 13% në fashën 60, 001 – 80, 000 lekë, 15% në fashën 80, 001 – 95, 000 lekë, 6% në fashën 95,001 lekë – 120,000 lekë dhe 11% paguhen më shumë se 120,001 lekë.

Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=72

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 13), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Për vitin 2025, asnjë të diplomuarve nuk merr një pagë më të ulët se 35.000 lekë. Këtu vihet re një rritje e përqindjes me 4 pikë përqindje krahasuar me vitin 2024.

Gjithashtu, ka ndryshuar edhe numri i të diplomuarve të cilët marrin një pagë 35,001-50,000 lekë me 10 pikë përqindje rritje (32% në 2025, 22% mesatarja 2017-2024), numri i të diplomuarve të cilët marrin 50,001-65,000 lekë me rënie 4 pikë përqindje (14% në 2025, 10% mesatarja 2017-2024). Për më tepër, është rritur me 7 pikë përqindje numri i të diplomuarve të cilët marrin 65,001 – 80,000 lekë (13% në vitin 2025, 6% mesatarja e viteve 2017-2024). Ndërkohë, viti 2025 shënon edhe numrin më të madh të të diplomuarve të cilët pohojnë se marrin një pagë më të lartë se 80,001 lekë, përkatësisht 40%. Mesatarisht, gjatë viteve 2017-2024, 14% e të diplomuarve e kanë marrë këtë pagë. Në këtë aspekt, viti 2025 shënon një rritje prej 26 pikësh përqindje në këtë fashë page.

Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2017-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=44); **2018** (N=24); **2019** (N=26); **2020** (N=51); **2021** (N=68); **2022** (N=104); **2023** (N=88), **2024** (N=77), **2025** (N=85)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), vëmë re se të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm kanë një shpërndarje në të gjitha fashat e pagave. Një pagë deri në 50,000 lekë e marrin 33% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione, 22% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 43% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm. Ndërkohë, një pagë 50,001 – 60, 000 lekë e marrin 39% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 12% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm. Pagë në fashën 60,001 lekë – 80,000 lekë marrin 17% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 12% e të diplomuarve në Hoteleri- Turizëm.

Një pagë në fashën 80,001 – 95,000 lekë e marrin 11% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 16% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 33% e të diplomuarve në Tekstil - Konfeksion. Ndërkohë 6% nga të diplomuarit në Hoteleri- Turizëm dhe 33% e të diplomuarve në Tekstil- Konfeksion marrin pagë në fashën 95,001- 120,000 Lekë. Pagë mbi 120,000 lekë marrin 11% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes dhe 12% e të diplomuarve në Hoteleri- Turizëm.


Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: EB**(N=22); **HT** (N=57); **TK** (N=6)

Nga të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 15), të dhënat tregojnë se 63% e të diplomuarve të gjinisë femërore dhe 30% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore marrin një pagë më të ulët se paga minimale. Një pagë 50, 001 – 60,000 lekë e marrin 18% të diplomuar të gjinisë mashkullore dhe 19% të diplomuara të gjinisë femërore. Ndërkohë, një pagë 60,001 -80,000 lekë e marrin 14% të diplomuar meshkuj dhe 6% të diplomuara të gjinisë femërore. Ndërkohë 20% të diplomuar të gjinisë mashkullore marrin 80,001 – 95,000 lekë. Ndërsa një pagë 95,001 – 120,000 lekë e marrin 7% të diplomuar të gjinisë mashkullore. Pagë mbi 120,000 lekë marrin 13% e diplomuar e gjinisë femërore dhe11% të diplomuar të gjinisë mashkullore.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza** N_M=56; N_F=16

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të shtatë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësimi me kohë të plotë. Mesatarisht 87% e të diplomuarve (2016-2025) punojnë me kohë të plotë një vit pas diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 7% e të diplomuarve (2016-2025) punojnë me kohë të pjesshme dhe 6% me kohë të plotë sezonale. Gjithësesi në 2025 vihet re një rritje e të punësuarve me kohë të plotë me 17 pikë përqindje krahasuar me vitin 2024.

Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2017-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=38); **2018** (N=20); **2019** (N=21); **2020** (N=42); **2021** (N=57); **2022** (N=92); **2023** (N=87); **2024** (N=68), **2025** (N=72)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve (2025) vërehet se 33% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës, 33% në kompani me 5-9 punonjës, 22% në kompani me 10-49 punonjës dhe 11% në kompani me më shumë se 50 punonjës.

Mesatarisht, nga viti 2017-2025, 36% e të diplomuarve kanë punuar në kompani me 5-9 punonjës, 32% e të diplomuarve kanë punuar në kompani me më shumë se 1-4 punonjës, 24% në kompani me 10-49 punonjës dhe 8% në kompani me më shumë se 50 punonjës.


Figura 17: Madhësia e kompanisë (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=38); **2018** (N=20); **2019** (N=21); **2020** (N=42); **2021** (N=57); **2022** (N=92); **2023** (N=87); **2024** (N=68), **2025** (N=72)

Në vitin 2024 51% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku, 19% kanë një kontratë me afat të caktuar dhe 31% kanë një kontratë me afat të pacaktuar. Ndërkohë, vijon të jetë i lartë numri i të diplomuarve të cilët nuk kanë një kontratë pune me punëdhënësin. Përkatësisht, 49% e të diplomuarve të punësuar nuk e kanë një kontratë pune me punëdhënësin, ku vihet rejë rritje prej 1 pikësh përqindje nga mesatarja 2017-2024, 48%.


Figura 18: Lloji i kontratës (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=38); **2018** (N=20); **2019** (N=21); **2020** (N=42); **2021** (N=57); **2022** (N=92); **2023** (N=87); **2024** (N=68), **2025** (N=72)

Sipas rezultateve të gjurmimit të të nëntë brezave, 67% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19), me nivelin më të lartë të ndërgjegjësimit të arritur në vitin 2023 me 87%. Ndërkohë, mesatarisht 24% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe 9% shprehen se nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet. Për vitin 2025 vihet re një rritje e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit krahasuar me vitin 2024 duke arritur 72%.

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=38); **2018** (N=20); **2019** (N=21); **2020** (N=42); **2021** (N=57); **2022** (N=92); **2023** (N=87); **2024** (N=68), **2025** (N=72)

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 73% e të diplomuarve në vitin 2025, u shprehën se ndjehen "të sigurt ose shumë të sigurt" (shiko tabelën 5). Këtu vërehet një rritje me 17 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (56%). Ndërkohë, 7% e të diplomuarve të gjurmuar janë shprehur se ndjehen "shumë të pasigurt". Mesatarisht, nga viti 2017 në vitin 2024, 10% e të diplomuarve kanë pohuar se ndjeheshin "shumë të pasigurt". Pra, vërehet një rënie e pasigurisë me 3 pikë përqindje nga mesatarja. Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 76% e të diplomuarve në vitin 2025 shprehen se ndjehen "të kënaqur ose shumë të kënaqur" dhe 7% u shprehen "shumë të pakënaqur". Të dhënat tregojnë një korrelacion pozitiv mes stabilitetit dhe kënaqësisë në vendin e punës.

Tabela 5: Perceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	0%	15%	14%	0%	14%	21%	5%	13%	**7%**
I/e pasigurt	3%	0%	14%	5%	14%	17%	0%	9%	**6%**
Neutral	21%	65%	33%	26%	25%	10%	21%	10%	**14%**
I/e sigurt	74%	20%	33%	67%	32%	29%	51%	40%	**29%**
Shumë i/e sigurt	3%	0%	5%	2%	16%	23%	24%	28%	**44%**
Shumë i/e pakënaqur	0%	10%	10%	0%	12%	1%	2%	10%	**7%**
I/e pakënaqur	3%	0%	14%	0%	9%	2%	2%	3%	**6%**
Neutral	21%	60%	14%	31%	21%	12%	20%	8%	**11%**
I/e kënaqur	71%	20%	57%	62%	46%	46%	49%	46%	**33%**
Shumë i/e kënaqur	5%	10%	5%	7%	12%	39%	26%	32%	**43%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=38); **2018** (N=20); **2019** (N=21); **2020** (N=42); **2021** (N=57); **2022** (N=92); **2023** (N=87); **2024** (N=68), **2025** (N=72)


Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë,

86% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur ta gjejnë punën para diplomimit, 6% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 3% janë punësuar 1 – 3 muaj pas diplomimit, 1% janë

punësuar 3 – 6 muaj pas diplomimit dhe 4% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit.

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=48); **2018** (N=21); **2019** (N=23); **2020** (N=43); **2021** (N=63); **2022** (N=107); **2023** (N=87); **2024** (N=68), **2025** (N=72)

Në një vështrim krahasues me vitet e mëparshme (shiko tabelën 6), mesatarisht 60% e të diplomuarve 2017-2024 kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit. Në këtë aspekt kemi një rritje me 26 pikë përqindje për vitin 2025, ku 86% e të diplomuarve arritën të gjejnë një punë para diplomimit. Ndërkohë, mesatarisht 10% e të diplomuarve arrijnë të gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit (2017-2024). Në këtë kategori kemi një ndryshim me rënie me 4 pikë përqindje për vitin 2025 ku 6% e të diplomuarve gjejnë punë 1 muaj pas diplomimit.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Para diplomimit	40%	43%	44%	28%	83%	82%	91%	73%	**86%**
1 muaj pas diplomimit	29%	10%	9%	16%	0%	7%	3%	9%	**6%**
1 - 3 muaj pas diplomimit	15%	10%	4%	5%	6%	3%	1%	9%	**3%**
3 - 6 muaj pas diplomimit	6%	14%	17%	14%	5%	3%	2%	4%	**1%**
6 - 9 muaj pas diplomimit	4%	24%	13%	14%	3%	2%	1%	2%	**0%**
9 - 12 muaj pas diplomimit	6%	0%	13%	23%	3%	4%	1%	3%	**4%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=48); **2018** (N=21); **2019** (N=23); **2020** (N=43); **2021** (N=63); **2022** (N=107); **2023** (N=87); **2024** (N=68), **2025** (N=25)

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të nëntë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. Mesatarisht, 70% e të diplomuarve gjatë viteve 2017-2024, kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale. Për të diplomuarit e vitit 2025 kjo përqindje është 50%, duke shënuar një ulje me 20 pikë përqindje.

Për më tepër, asnjë prej të diplomuarve të vitit 2025 kanë gjetur punë nga mësuesit, me një rënie prej 7 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024.

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	**2023**	**2024**	**2025**
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	3%	0%	0%	0%	4%	1%	3%	10%	**15%**
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	84%	75%	90%	79%	63%	62%	53%	54%	**50%**
Nga praktika profesionale në biznes	11%	0%	0%	10%	23%	24%	15%	16%	**29%**
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	0%	20%	0%	7%	4%	2%	2%	3%	**0%**
Nga mësuesit	0%	0%	5%	0%	5%	10%	25%	15%	**0%**
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	3%	5%	5%	5%	0%	1%	1%	1%	**6%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017**(N=38); **2018** (N=20); **2019** (N=21); **2020** (N=42); **2021** (N=57); **2022** (N=92); **2023** (N=87); **2024** (N=68), **2025** (N=72)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2025, 38% kanë pohuar se shkolla i ka ndihmuar të aplikojnë për punë, me një ulje prej 20 pikësh përqindje nga mesatarja 2017-2024; 37% pohuan se shkolla i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (rritje me 7 pikë përqindje nga mesatarja 2017-2024, 30%); 22% pohuan se shkolla i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë (rritje me 1 pikë përqindje nga mesatarja 2017-2024, 21%). Ndërkohë, 6% e të diplomuarve pohojnë se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar me një rënje prej 14 pikësh përqindje nga mesatarja 2017-2024, 20%.

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2017-2025)

	2017	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	57%	88%	64%	90%	35%	38%	56%	33%	**38%**
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	35%	8%	14%	8%	37%	49%	56%	34%	**37%**
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me	2%	8%	14%	2%	28%	39%	48%	22%	**22%**


punëdhënës potencialë									
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	9%	4%	11%	0%	32%	18%	18%	16%	**6%**
Tjetër	0%	4%	0%	0%	3%	5%	1%	7%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017; (**N=54); **2018 (**N=24); **2019** (N=28); **2020** (N=51); **2021** (N=68); **2022** (N=104); **2023** (N=102); **2024** (N=77), **2025** (N=72)

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2025, 3% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se janë të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë, duke mbajtur te njëjtën përqindje me mesataren 2017-2024, 3%. Ndërkohë, studime të mëtejshme ndjekin 6%, me një ulje prej 5 pikësh përqindje nga mesatarja 2017-2024 (11%).


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017; (**N=91); **2018 (**N=60); **2019** (N=55); **2020** (N=88); **2021** (N=93); **2022** (N=144); **2023** (N=148); **2024** (N=118), **2025** (N=131)

Në vitin 2025 të gjithë të diplomuarit që vijojnë kualifikimet e mëtejshme pra 100% e tyre janë shprehur që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017; (**N=16); **2018 (**N=10); **2019** (N=10); **2020** (N=8); **2021** (N=4); **2022** (N=22); **2023** (N=10); **2024** (N=17), **2025** (N=8)

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, të gjithë pra 100% studiojnë në institucione publike. Mesatarisht, 2020-2025, 93% e të diplomuarve studiojnë në institucione publike dhe 7% në institucione private.


Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017; (**N=16); **2018 (**N=10); **2019** (N=10); **2020** (N=8); **2021** (N=4); **2022** (N=22); **2023** (N=10); **2024** (N=17), **2025** (N=8)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 24), 88% e të gjurmuarve mohojnë lidhjen mes studimeve dhe profesionit, me një rritje prej 27 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2020-2024. Ndërkohë, 13% kanë pohuar lidhjen mes studimeve dhe profesionit, me një rënie prej 26 pikësh përqindje nga mesatarja 2017-2024, 39%.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=8); **2021** (N=4); **2022** (N=22); **2023** (N=10); **2024** (N=17), **2025** (N=20)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 63% janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë (47% mesatarja 2017-2024), 0% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (33% mesatarja 2017-2024) dhe 38% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (22% mesatarja 2017-2024).

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2017-2025)


	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	44%	60%	38%	75%	25%	50%	40%	41%	**63%**
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	56%	20%	25%	0%	25%	23%	40%	41%	**0%**
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	0%	10%	38%	25%	50%	23%	20%	12%	**38%**
Nuk po gjeja dot punë	0%	10%	0%	0%	0%	0%	0%	6%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017; (**N=16); **2018 (**N=10); **2019** (N=10); **2020** (N=8); **2021** (N=4); **2022** (N=22); **2023** (N=10); **2024** (N=17), **2025** (N=11)

Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2025 është 18%, me një rënie me 9 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2017-2024 (27%).


Figura 25: Papunësia ndër vite (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017; (**N=91); **2018 (**N=60); **2019** (N=55); **2020** (N=88); **2021** (N=93); **2022** (N=144); **2023** (N=148); **2024** (N=118), **2025** (N=131)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 63% e të diplomuarve të papunë të vitit 2025 u përgjigjën që po kërkonin punë. Ndërkohë 38% nuk janë në kërkim të një pune. Sikundër tregohet edhe në figurën 26, viti 2025 shënon edhe përqindjen më të lartë të të diplomuarve të papunë të cilët janë në kërkim të një pune.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=27); **2021** (N=21); **2022** (N=26); **2023** (N=35); **2024** (N=30), **2025** (N=24)

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: mungesa e eksperiencës në punë (26% në 2024, 8% mesatarja e viteve 2017-2023), ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim (33% në 2025, 21% mesatarja e viteve 2017-2024), mungesa e njohjeve dhe kontakteve të duhura për të gjetur punë (33% në 2025, 23% mesatarja e viteve 2017-2024), mungesa e punës në qark (22% në 2025, 8% mesatarja e viteve 2017-2024) dhe mungesa e eksperiencës së punës (11% në 2025, 10% mesatarja e viteve 2017-2024).

Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës	3%	0%	0%	0%	10%	27%	14%	26%	**11%**
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	3%	0%	0%	0%	0%	13%	0%	11%	**0%**
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	14%	39%	6%	67%	10%	7%	14%	11%	**33%**
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	31%	22%	44%	27%	20%	7%	0%	32%	**33%**
Nuk ka punë në qarkun tim	7%	17%	11%	7%	0%	7%	14%	11%	**22%**
Jam i/e angazhuar në punë familjare	38%	22%	22%	0%	0%	0%	14%	5%	**0%**
Tjetër	3%	0%	0%	0%	50%	33%	43%	5%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017; (**N=29); **2018 (**N=18); **2019** (N=18); **2020** (N=15); **2021** (N=10); **2022** (N=15); **2023** (N=7); **2024** (N=19), **2025** (N=15)

Të diplomuarit e papunë që janë në kërkim të një pune janë pyetur më tej për metodat në kërkimin e punës (shiko tabelën 11). Metoda mbizotëruese për të pesë brezat e gjurmuar të cilëve ju është drejtuar kjo pyetje është nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve (47% në 2025, 78% mesatarja 2017-2024). Mbani parasysh që kjo është një pyetje ku të anketuarit mund të japin më shumë se një përgjigje. Për 27%

metoda më e përdorur ka qenë nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.

Tabela 11: Metodat e kërkimit për punë (2020-2025)

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Nëpërmjet Zyrës së Punës	0%	0%	7%	0%	0%	**13%**
Nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	0%	10%	13%	14%	47%	**27%**
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	93%	80%	73%	100%	42%	**47%**
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me bizneset (duke dërguar CV etj.)	0%	20%	27%	14%	11%	**0%**
Nëpërmjet shkollës	0%	10%	13%	0%	11%	**13%**
Tjetër	7%	10%	0%	0%	0%	**13%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=15); **2021** (N=10); **2022** (N=15); **2023** (N=7); **2024** (N=19), **2025** (N=15)

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit për punë (shiko tabelën 12), 9% e të diplomuarve të papunë në vitin 2025 u shprehën se po prisnin të fillonin punë së shpejti, 36% u shprehën se nuk kishin dëshirë të punonin për momentin, 27% u shprehën se planifikonin të largoheshin nga vendi dhe 27% u shprehën se kujdesen për fëmijët/familjen.


Tabela 12: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025)

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Po pres të filloj punë së shpejti	0%	0%	0%	14%	**46%**	**9%**
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	0%	0%	27%	21%	**27%**	**36%**
Kam në plan të largohem nga vendi	83%	36%	18%	29%	**18%**	**27%**
Kujdesem për fëmijët/familjen	8%	55%	36%	18%	**0%**	**27%**
Jam me aftësi ndryshe	0%	0%	0%	18%	**9%**	**0%**
Tjetër	8%	9%	18%	0%	**0%**	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=12); **2021** (N=12); **2022** (N=12); **2023** (N=28); **2024** (N=11), **2025** (N=11)

Për vitin 2024, 58% e të diplomuarve të papunë nuk kanë qenë më herët në marrëdhënie pune. Mesatarisht, 71% e të diplomuarve 2017-2025 nuk kanë qenë më herët në marrëdhënie pune.

Figura 27: Të diplomuarit papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2017-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017; (**N=29); **2018 (**N=18); **2019** (N=18); **2020** (N=27); **2021** (N=21); **2022** (N=26); **2023** (N=35); **2024** (N=30), **2025** (N=24)

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë "shumë/jashtëzakonisht shumë" nevojë për përmirësim. Sikundër vihet re edhe nga tabela, përqindja e të diplomuarve të cilët kërkojnë përmirësimin e aspekteve të ndryshme në shkollë është ulur ndjeshëm në raport me vitin 2024 për secilën prej aspekteve. Vërehet se theksi vendoset tek përmirësimi i teksteve dhe materialeve (33%), përmirësimi i bashkëpunimit me bizneset (32%), praktika në biznes (32%), aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (32%), metodat e mësimdhënies (32%) etj.

Tabela 13: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2017-2025)


	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Infrastruktura	20%	17%	18%	0%	37%	21%	76%	49%	**29%**
Kurrikula		21%	11%	0%	35%	19%	80%	46%	**31%**
Tekstet dhe materialet	7%	21%	18%	0%	39%	23%	80%	54%	**33%**
Metodat e mësimdhënies	9%	17%	18%	0%	40%	24%	84%	49%	**32%**
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve		17%	14%	0%	38%	26%	84%	51%	**32%**
Praktika në shkollë	17%	21%	14%	36%	39%	27%	82%	59%	**31%**
Praktika në biznes	15%	17%	32%	41%	44%	27%	81%	57%	**32%**
Këshillimi i karrierës	11%	17%	4%	11%	38%	33%	76%	61%	**30%**

Bashkëpunimi me bizneset		21%	32%	92%	46%	33%	75%	60%	**32%**
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	39%	96%	68%	100%	52%	39%	74%	57%	**32%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017; (**N=54); **2018 (**N=24); **2019** (N=28); **2020** (N=88); **2021** (N=56); **2022** (N=144); **2023** (N=134); **2024** (N=103), **2025** (N=107)

Nëse do të kishin mundësi 95% e të diplomuarve në vitin 2024 do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 93% do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë (shiko figurën 29). Mesatarisht, 2018-2025, 92% do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 89% të njëjtën shkollë.

Figura 28: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=60); **2019** (N=56); **2020** (N=88); **2021** (N=93); **2022** (N=144); **2023** (N=148); **2024** (N=118), **2025** (N=131)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 14. Për vitin 2025 100% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione, 95% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 94% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Ndërkohë, 94% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, 91% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione dhe 91% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.

Mesatarisht, 2018-2025, 94% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, 92% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 92% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Ndërkohë, mesatarisht 2018-2025, 84% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes, 92% e të diplomuarve në Hoteleri- Turizëm dhe 81% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.


Tabela 14: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025)

		Ekonomi -Biznes	Hoteleri-Turizëm	Tekstil-Konfeksione
2018	Degë	100%	97%	100%
	Shkollë	100%	97%	82%
2019	Degë	94%	92%	79%
	Shkollë	100%	100%	100%
2020	Degë	100%	96%	100%
	Shkollë	100%	100%	91%
2021	Degë	78%	87%	83%
	Shkollë	44%	81%	50%
2022	Degë	94%	92%	83%
	Shkollë	77%	86%	50%
2023	Degë	93%	96%	100%
	Shkollë	68%	89%	83%
2024	Degë	97%	83%	87%
	Shkollë	94%	87%	100%
2025	**Degë**	**94%**	**95%**	**100%**
	Shkollë	**91%**	**94%**	**91%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018**: N_{EB}=16; N_{HT}=33; N_{TK}=11; **2019**: N_{EB}=16; N_{HT}=26; N_{TK}=14; **2020**: N_{EB}=31; N_{HT}=46; N_{TK}=11; **2021**: N_{EB}=18; N_{HT}=63; N_{TK}=12; **2022:** N_{EB}=17; N_{HT}=109; N_{TK}=18; **2023:** N_{EB}=28; N_{HT}=114; N_{TK}=6, **2024:** N_{EB}=33; N_{HT}=70; N_{TK}=15, **2025:** N_{EB}=35; N_{HT}=84; N_{TK}=12

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi dhe shkollë jepet në figurën 30. Sikurse vihet re 90% e vajzave dhe 95% e djemve do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Ndërkohë, të njëjtën shkollë do e përzgjidhnin 95% e vajzave dhe 96% e djemve.

Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2025



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M (**N=56); **F** (N=16)

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 15), 57% e të diplomuarve kanë dëshirë të fillojnë biznesin e tyre, me një rritje prej 27 pikë përqindje nga mesatarja 2017-2024 (25%). Për më tepër, 18% kanë dëshirë të jenë të punësuar. Ndërkohë, 13% kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimeve, me një ulje prej 9 pikësh përqindje në raport me mesataren 2017-2024 (24%).

Tabela 15: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2017-2025)

	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të jem punësuar	11%	37%	41%	31%	31%	24%	11%	22%	**18%**
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	43%	30%	23%	28%	12%	15%	23%	20%	**13%**
Të kem filluar biznesin tim	23%	7%	4%	10%	34%	32%	30%	58%	**57%**
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	15%	17%	16%	10%	6%	9%	9%	9%	**11%**
Të kem emigruar jashtë vendit	19%	20%	13%	16%	26%	33%	36%	9%	**12%**
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	0%	0%	2%	0%	2%	0%	2%	3%	**4%**
Tjetër	0%	0%	5%	6%	9%	8%	2%	3%	**6%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2017 (**N=91); **2018 (**N=60); **2019** (N=56); **2020** (N=88); **2021** (N=93); **2022** (N=144); **2023** (N=148); **2024** (N=118), **2025** (N=131)

Përfundime dhe rekomandime për Njësinë e Zhvillimit

Gjurmimi i brezit 2024–2025 arriti mbulim të plotë (131 nga 131, 100%), ndaj ky brez është baza më e besueshme e shkollës për krahasimet në vijim. Punësimi/vetëpunësimi arriti 74% (mesatarja 2017–2024: 60%) dhe 86% e të punësuarve e gjetën punën para diplomimit. Praktika në biznes u bë kanali i dytë më i rëndësishëm i punësimit (29%), pas rrjetit familjar e shoqëror (50%). Fushat që kërkojnë vëmendje janë papunësia dhe pagat e ulëta te vajzat, profilet Tekstil-Konfeksione dhe Ekonomi-Biznes, si dhe kushtet e punës, veçanërisht mungesa e kontratës.

1. Gjurmimi si praktikë e përhershme
Mbulimi i arritur në 2025 të ruhet si standard i shkollës, dhe krahasimet me brezat e mëparshëm të lexohen si orientuese.
Gjetja: U gjurmuan 131 nga 131 të diplomuar (100%), kundrejt 118 nga 122 (97%) në 2024. Në 2017–2019 mbulimi ishte 69–89%.

2. Praktika në biznes si kanal i drejtpërdrejtë punësimi
Shkolla të ndërtojë një regjistër të bizneseve ku punësohen nxënësit pas praktikës dhe t'i prioritizojë ato në planifikimin e praktikave. Mësuesit dhe Njësia e Zhvillimit të marrin rol të përcaktuar në ndërmjetësimin me punëdhënësit.
Gjetja: 29% e të punësuarve (N=72) e gjetën punën e parë përmes praktikës në biznes (16% në 2024), 50% përmes njohjeve (mesatarja 2017–2024: 70%), 6% përmes qendrës së karrierës/Njësisë së Zhvillimit dhe 0% përmes mësuesve (25% në 2023). Vetëm 22% thonë se shkolla i ka ndihmuar të vendosin kontakte me punëdhënës, kundrejt 38% që thonë se i ka mësuar të aplikojnë dhe 37% që i ka orientuar. Praktika në biznes dhe bashkëpunimi me bizneset renditen secila me 32% si fusha me nevojë për përmirësim.

3. Ndjekja e të diplomuarve të papunë
Të diplomuarit e papunë të kontaktohen individualisht dhe t'u ofrohet referim në Zyrën e Punësimit dhe lidhje me punëdhënës.
Gjetja: 24 të diplomuar (18%) janë të papunë, kundrejt mesatares 27% në 2017–2024. Prej tyre, 63% (15) po kërkojnë punë dhe 38% (9) jo. Metoda më e shpeshtë e kërkimit është rrjeti personal (47%), pastaj njoftimet online (27%), ndërsa vetëm 13% përdorin Zyrën e Punës dhe 13% shkollën. Arsyet kryesore janë ofertat që nuk lidhen me arsimin (33%), mungesa e kontakteve (33%) dhe mungesa e punës në qark (22%, kundrejt 8% mesatare). Baza e arsyeve është shumë e vogël, ndaj ato lexohen vetëm cilësisht.

4. Analiza dhe mbështetja e synuar sipas gjinisë
Shkolla të analizojë çdo vit rezultatet sipas gjinisë dhe drejtimit, të identifikojë pengesat për

punësimin e vajzave dhe t'u ofrojë atyre praktika, orientim dhe lidhje me punëdhënës.
Gjetja: Vajzat janë 30% e të gjurmuarve (N=39), por 12 nga 24 të papunët janë vajza. Punësimi është 59% te vajzat kundrejt 80% te djemtë dhe papunësia 31% kundrejt 13%. Në fashën më të ulët të pagave (deri në 50,000 lekë) janë 63% e vajzave (N=16) kundrejt 30% të djemve (N=56). Lidhja e punës me arsimin është e ngjashme (75% dhe 71%). Baza e vajzave të punësuara është e vogël, ndaj gjetja kërkon verifikim cilësor.

5. Rishikimi i profileve Tekstil-Konfeksione dhe Ekonomi-Biznes
Të dy profilet të rishikohen me bizneset e sektorit, me fokus te përmbajtja e praktikës dhe mundësitë e punësimit. Rishikimi për Tekstil-Konfeksione të jetë cilësor.
Gjetja: Në Tekstil-Konfeksione (N=12) 50% janë të punësuar dhe 33% të papunë, dhe 67% e atyre që punojnë (N=6) nuk punojnë në profesion. Në Ekonomi-Biznes (N=35) 74% janë të punësuar dhe 23% (8 persona) të papunë, ndërsa 55% punojnë në fushën e studimit (N=22). Mesatarisht 2017–2025, lidhja e punës me arsimin është 70% në Hoteleri-Turizëm, 36% në Tekstil-Konfeksione dhe 30% në Ekonomi-Biznes. Në Hoteleri-Turizëm (N=84) 77% janë të punësuar dhe 82% punojnë në fushë. Pavarësisht kësaj, 100% e diplomuarve në Tekstil-Konfeksione, 95% në Hoteleri-Turizëm dhe 94% në Ekonomi-Biznes do ta zgjidhnin sërish të njëjtën degë.

6. Kushtet e punës, të drejtat në punë dhe sipërmarrja
Në vitin e fundit të përfshihet një modul i shkurtër për kontratën e punës, sigurimet shoqërore dhe hapat për nisjen e një biznesi.
Gjetja: Sipas raportit, 49% e të punësuarve nuk kanë kontratë pune. 72% thonë se punëdhënësi u paguan kontributet (mesatarja e nëntë brezave: 67%). 66% punojnë në kompani me më pak se 10 punonjës dhe 37% marrin pagë deri në 50,000 lekë (N=72). Njëkohësisht 57% planifikojnë të nisin biznesin e tyre brenda dy viteve (mesatarja 2017–2024: 25%), dhe 19% (N=25) janë tashmë të vetëpunësuar.